

VENDIM
Nr. 33, datë 2.7.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN E
KONSOLIDUAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nënkreut II të kreut VI të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për mbikëqyrjen e konsoliduar”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 1.2.2017, e ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në aneksin 4, në udhëzuesin shpjegues për plotësimin e formularit nr. 1, përshkrimi i kolonës nr. 27, ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

“Shuma e përjashtimeve në përputhje me shkronjat “a”, “b”, pjesërisht shkronjën “d”, pjesërisht shkronjën “e” dhe shkronjat “b”, “i”, “j”, “l”, “m”, “n”, “p” dhe “q”, të pikës 2 të nenit 8 të rregullores “Për administrimin e rreziqut nga ekspozimet e mëdha”.”.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko